

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-078/2015

Prishtinë,  
2 Nëntor 2016

Në çështjen juridike të:

**Xh. B.**

**Pala ankuese**

kundër

**S. M.**

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK) nr. KPCC/D/R/247/2014 të datës 18 qershor 2014 (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës me numrin KPA00336), po ashtu më tutje: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 Nëntor 2016, mori këtë

## AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e pa afatshme ankesa e Xh. B. kundër Vendimit të KKPK-së nr. KPCC/D/R/247/2014, të datës 18 qershor 2014, për sa i përket kërkesës nr KPA00336.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 9 shkurt 2007, Xh. B. (më tutje: Pala Ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e bodrumit, që ndodhet në Prishtinë, Mikronaselje nr. C/15, hyrja nr. VII, me sipërfaqe prej 14 m<sup>2</sup> (më tutje: bodrumi i kërkuar).
2. Pala ankuese dorëzoi *inter alia* në AKP:
  - Një Kontratë për Blerje të lidhur ndërmjet tij dhe Z. V. J. të datës 24 shtator 1999 për një banesë në Prishtinë, Mikronaselje nr. C/15, hyrja nr. VII, kati i parë, nr. 4 me sipërfaqe prej 57.60 m<sup>2</sup> dhe bodrumin e asaj banese, me sipërfaqe prej 14 m<sup>2</sup>.
3. AKP-ja identifikoi pronën e kërkuar më 20 korrik 2007 dhe gjeti se e njëjta ishte e uzurpuar nga S. M. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë).
4. Pala përgjegjëse në ankesë ka marrë pjesë në procedurën para KKPK-së. Ai pretendoi se kishte të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar. Ai deklaroi se bodrumin e kërkuar e kishte uzurpuar në shtator të vitit 1999 dhe e kishte shndërruar në banesë.
5. Në vendimin e saj, KKPK-ja vendosi që ta hedh kërkesën poshtë. Në arsyetimin e saj (paragrafët 9 dhe 19), për aq sa është relevante, KKPK-ja deklaroi se pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesa e tij përfshin rrethana që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999 dhe rrjedhimisht kërkesa bie jashtë juridiksionit të KKPK-së
6. Vendimi i është dorëzuar Palës Ankuese të mërkurën më 1 tetor 2014 dhe Palës Përgjegjëse në Ankesë më 16 tetor 2014.
7. Pala Ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së të martën më 4 nëntor 2014.

8. Pala përgjegjëse në ankesë dërgoi një përgjigje ndaj ankesës.

### **Pretendimet e palëve**

9. Pala ankuese pretendon se ai i ka dorëzuar të gjitha provat ligjore rreth blerjes së banesës dhe bodrumit të kërkuar. Ai më tej deklaron se e kupton që afati ligjor për dorëzimin e një ankese është një muaj nga pranimi i vendimit të KKPK-së, por se ai nuk ka mundur ta paraqesë ankesën për arsye shëndetësore.
10. Pala përgjegjëse në ankesë konteston se pala ankuese ka prova ligjore për blerjen e bodrumit të kërkuar. Ai propozon që ankesa të hidhet poshtë pasi që ajo është paraqitur pas afatit ligjor.

### **Arsyetimi ligjor**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

11. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (më tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) parasheh si në vijim: “Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës te Gjykata Supreme e Kosovës”.
12. Nga faktet e vërtetuara rrjedh se pala ankuese ankesën e kishte paraqitur 34 ditë pas pranimit të vendimit të KKPK-së. Sikurse e pranon edhe vet pala ankuese, kjo do të thotë se ai nuk e ka paraqitur ankesën brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me dispozitën e lartcekur.
13. Pala ankuese pretendon se për shkaqe shëndetësore ai nuk ka qenë në gjendje që ta paraqet ankesën brenda afatit, por ai nuk e argumentoi këtë pretendim e as nuk paraqiti ndonjë provë për ta mbështetur atë. Prandaj, ky pretendim nuk përbën një arsyetim justifikues për paraqitjen e ankesës pas afatit.
14. Prandaj, ankesa duhet të hidhet poshtë si e pa afatshme në përputhje me nenin 13.3 nën-paragrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 195.1 (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**Këshillë ligjore**

15. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it**